

3. BURIMET NJERËZORE DHE KAPACITETET INFRASTRUKTURE

Banka e Shqipërisë synon të zhvillojë kapitalin e saj njerëzor në përputhje me objektivat strategjike dhe politikat përkatëse, duke krijuar një mjedis pune të favorshëm dhe motivues. Kjo qasje jo vetëm që ndihmon në rritjen e profesionalizmit dhe kompetencave të punonjësve, por gjithashtu kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve administrative të institucionit.

3.1. BURIMET NJERËZORE


Në përputhje me objektivat strategjike afatmesëm të institucionit, menaxhimi i burimeve njerëzore synon të zbatojë praktikrat dhe modelet më të avancuara në këtë fushë. Fokusi ynë është zhvillimi profesional i stafit, krijimi i një mjedisi pune motivues dhe me përgjegjësi të lartë, si dhe përmirësimi i kuadrit ligjor dhe i strukturës organizative të Bankës. Kjo është arritur përmes adoptimit dhe zbatimit të vazhdueshëm të praktikave më të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore, të aplikuara në institucione të ngjashme në Bashkimin Evropian.

Menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore kërkon një përditësim dhe përshtatje të vazhdueshme të infrastrukturës rregullative të institucionit, duke e harmonizuar atë me standardet më të mira dhe duke mundësuar zhvillim dhe avancim të vazhdueshëm për punonjësit me përvojë profesionale. Përmes politikave të orientuara drejt rritjes së kompetencave profesionale, synohet ruajtja e stabilitetit të stafit dhe identifikimi i talenteve të reja. Zbatimi i politikave për punësimin, menaxhimin dhe avancimin në karrierë ka për qëllim krijimin dhe mbajtjen e një strukture organizative efikase, profesionale dhe dinamike. Gjithashtu, racionalizimi i strukturës organizative dhe përmirësimi i performancës

institucionale, në përputhje me objektivat strategjike dhe kuadrin rregullativ përkatës, mbeten në qendër të këtyre politikave.

Disa statistika, përfshirë përfaqësimin gjinor dhe formimin profesional, për stafin e Bankës jepen në vijim. Raporti i femrave ndaj meshkujve në totalin e punonjësve është rreth 60% - 40%, ndërkohë që ky raport në nivel drejtues është 62% - 38%. Moshë mesatare e stafit është 47 vjeç, ndërkohë që një kujdes i veçantë i është kushtuar edhe kombinimit të stafit me përvojë me stafin e ri. Rreth 88% e punonjësve në Bankë janë me arsim të lartë dhe rreth 58% e tyre kanë përfunduar studime pasuniversitare në nivel Master/PhD, si dhe kanë përfunduar certifikata profesionale të njohura nga institucione ndërkombëtare.

Grafik 55. Raporti femra/meshkuj në Bankën e Shqipërisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.



Një element i rëndësishëm i politikave të burimeve njerëzore është edhe ofrimi i trajnimeve cilësore, brenda dhe jashtë vendit, për zbatimin e proceseve të reja të punës. Pjesëmarrja e stafit në trajnime të specializuara, të organizuara nga banka të ndryshme qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare apo të tjera, i shërben stafit për rritjen e njohurive profesionale dhe për shkëmbimin e përvojave profesionale dhe menaxheriale me përfaqësuesit e institucioneve të tjera financiare.

Aktivitetet e trajnimit profesional kanë mbuluar një gamë të gjerë të funksioneve të Bankës, duke synuar ndërtimin e kapaciteteve institucionale të bankës qendrore. Shpërndarja e tyre për vitin 2024 është si vijon: në fushën e Sistemeve të Pagesave (10.73%), Bankingut Qendror (9.87%), Statistika Financiare (9.01%), Mbikëqyrjes Bankare (8.15%), Operacione Monetare (7.30%) si dhe Informatikë (7.30%). Pjesa tjetër e trajnimeve janë zhvilluar në fusha të tilla si: politika monetare, ndërhyrja e jashtëzakonshme, teknologjia e informacionit, auditimi i brendshëm, etj.

Në vijimësi të viteve të kaluara, aktivitetet trajnuese janë realizuar, ndër të tjera, edhe përmes platformave online.

Gjatë vitit 2024, janë organizuar disa aktivitete në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të Bankës me institucione homologe si: State Secretariat for Economic Affairs (SECO), Komisioni Evropian, ECB dhe Banka e Gjermanisë, European Banking Authority (EBA) etj. Me qëllim marrjen e informacionit të targetuar dhe specifik, nga këto marrëveshje janë realizuar 27 aktivitete të formave të ndryshme, ku kanë marrë pjesë rreth 65 punonjës të Bankës.



3.2. PËRMIRËSIME NË INFRASTRUKTURË

Banka e Shqipërisë ka vijuar me përmirësimet e vazhdueshme në sistemet dhe në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit.

Një vëmendje e posaçme i është kushtuar sigurisë kibernetike. Në këtë drejtim janë ndërmarrë një sërë iniciativash – në funksion të rritjes së nivelit të sigurisë së infrastrukturës dhe sistemeve informatike – përfshirë përsosjen e mëtejshme të bazës rregullatore e procedurale, planeve të vijimësisë, përditësimit të Sistemeve të Sigurisë e Mbrojtjes. Këto iniciativa ndihmojnë në sigurimin e një reagimi sa më të shpejtë ndaj ngjarjeve të sigurisë, si dhe rrisin shkallën e ndërgjegjësimit dhe reagimit ndaj kërcënimeve kibernetike.

Banka e Shqipërisë ka intensifikuar kontrollet dhe monitorimet mbi sistemet dhe shërbimet që ofron. Gjithashtu, një vëmendje e veçantë i është kushtuar intensifikimit të fushatave ndërgjegjësuese për rritjen e nivelit të gatishmërisë së stafit përgjegjës, si dhe rritjen e vigjilencës së çdo punonjësi në përdorimin e sistemeve dhe shërbimeve elektronike për mënyrën e reagimit ndaj formave të ndryshme të kërcënimeve me të cilat mund të përballen, për të mos rënë pre e kërcënimeve kibernetike.

Banka e Shqipërisë ka ndjekur në mënyrë të kujdesshme çdo ngjarje kibernetike në Republikën e Shqipërisë, dhe jo vetëm, duke intensifikuar në të njëjtën kohë edhe bashkëpunimin me institucione të huaja dhe vendase në kuadër të përmirësimit të sigurisë, si Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), si dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave.

Një objektiv tjetër i rëndësishëm i Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 2024, ka qenë modernizimi i mëtejshëm i sistemeve të pagesave në aspektin infrastrukturor. Kjo qasje vjen si përgjigje ndaj zhvillimeve teknologjike, i paraprin integritet evropian dhe zgjerimit të përdorimit të shërbimeve elektronike të pagesave në nivel kombëtar e rajonal, dhe, në të njëjtën kohë, i përgjigjet nevojës për të aplikuar rregulla të forta të sigurisë dhe masa mbrojtëse me qëllim adresimin e të gjitha rreziqeve. Ajo realizohet nëpërmjet zbatimit të standardeve më të mira ndërkombëtare dhe të akteve ligjore e rregullatore të miratuara në nivel kombëtar për sigurinë kibernetike.

